

RAPORT MBI VEPRIMTARINË E
AUTORITETIT TË KONTROLLIT
SHTETËROR TË EKSPORTEVE
PËR VITIN 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES



Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, si institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave shtetërore në fushën e kontrollit shtetëror mbi eksportin, importin, kalimin tranzit, transferimin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë ka ushtruar, gjatë vitit 2024, detyrat e përcaktuara nga legjislacioni përkatës.

Kryesisht veprimtaria e këtij institucioni përqëndrohet në kontrollin shtetëror mbi transferimet e mallrave të mësipërme, duke përfshirë fazat e kontrollit, analizës dhe ekspertizës mbi mallrat dhe veprimtaritë, verifikimin e mundësisë së lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave ndaj subjekteve aplikues, vendimmarrjen dhe sanksionimin e shkeljeve ligjore.

Rol tejet të rëndësishëm, AKSHE luan gjithashtu falë kompetencës ligjore për të qenë pikë kontakti në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë, duke implementuar procedurat dhe detyrimet që përcaktohen nga normat ndërkombëtare, duke zbatuar embargot e plota apo të pjesshme, duke analizuar me kujdes destinacionet dhe përdorimin përfundimtar si dhe me shkëmbimin konstant të informacioneve në lidhje me subjektet tregtare të përfshira në operacione të paligjshme.

Në mënyrë më të detajuar, veprimtaria e AKSHE-së në vitin 2024, është fokusuar në tetë drejtime kryesore:

- A. Hartimi dhe përmirësimi i akteve normative nënligjore për kompletimin e bazës ligjore të veprimtarisë së kontrollit shtetëror të eksporteve;
- B. Lëshimi i dokumenteve ligjore: licenca, autorizime dhe certifikata;
- C. Lëshimi i licencave në fushën e lëndëve plasëse për përdorim civil, si dhe lëndëve piroteknike, fishekzjarrë;
- Ç. Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë, kombëtarë, bashkëpunimi me autoritetet homologe dhe pjesëmarrja në konferenca dhe seminare, në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve;
- D. Bashkëpunimi me insitucionet kombëtare në fushën e kontrollit të eksporteve.

DH) Bashkëpunimi me Autoritetet homologe

E. Përgatitja e Raportimeve Vjetore në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare.

Ë. Vijimi i trajnimit të personelit.

A) Hartimi dhe përmirësimi i akteve normative nënligjore, për kompletimin e bazës ligjore të veprimtarisë së kontrollit shtetëror të eksporteve:

Hartimi i akteve normative nënligjore të parashikuara nga ligji nr. 46/2018 datë 23.07.2018 "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", i ndryshuar, të cilat do të bënin të mundur funksionalitetin e plotë të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, si dhe përafrimi i legjislacionit me *acquis communautaire* në këtë fushë ka qenë prioriteti i kësaj agjencie që në momentet e para të krijimit të saj.

a) Legjislacioni në fuqi mbi Kontrollin e Eksporteve

I. Ligji nr. 46/2018 datë 23.07.2018

"Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", i ndryshuar.

II. Ligji Nr. 6/2014, datë 30.01.2014

"Për ratifikimin e "Traktatit për tregtinë e armëve".

III. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 22.01.2020

"Për organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe të procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si dhe përcaktimin e procedurave për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror".

IV. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 01.09.2024

"Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve",

V. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 10.4.2019

"Përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve teknologjive me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve"

VI. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 28.8.2003

"Për miratimin, në parim, të Kodit të Sjelljes së Bashkimit Europian për eksportin e armëve"

Objektivat në hartimin e legjislacionit:

Gjatë vitit 2024 dhe 2025,

- Është hartuar dhe miratuar në Kuvendin e Shqipërisë Ligji, Nr. 89/2024, datë 26.7.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 46/2018 "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", i ndryshuar.

- Është hartuar dhe miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 01.08.2024, "Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare".
- Është hartuar dhe miratuar Vendimit Nr. 248, datë 30.04.2025, "Për përcaktimin e llojeve të licencave/certifikatave dhe autorizimeve, të dokumentacionit të aplikimit, formateve të kërkesave të aplikimeve, si dhe të formateve të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për transferimet ndërkombëtare për mallrat ushtarake dhe artikujt e teknologjitë me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të eksporteve".
- Është hartuar dhe miratuar vendimi Nr. 323 11.06.2025, "Për miratimin e modeleve standarde të autorizimeve, individuale, të përgjithshme e globale, për tregtimin e produkteve, që janë objekt i kontrollit shtetëror, të cilat mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, e të formateve të kërkesave për këto dokumente dhe përcaktimin e afateve, procedurave e tarifave për lëshimin e autorizimeve".
- Është hartuar dhe miratuar vendimi Nr. 97 datë 12.02.2025, "Për përcaktimin e formatit të raportimit, afateve dhe kohës së paraqitjes së raporteve nga subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara".

Për vitin 2025 si objektiva kryesore në hartimin e legjislacionit janë :

- Në fushën e kontrollit mbi transferimet e mallrave ushtarake e mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë:

1. Miratimi në Kuvendin e Shqipërisë Projekt-Ligjit "*Për dësa shtesa dhe ndryshime në ligjin 46/2018 "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë"*", i ndryshuar i cili do të bëhet në përputhje me Rregulloren e re të Bashkimit Europian për kontrollin e mallrave me përdorim të dyfishtë
2. Përditësimi i listave të kontrollit për mallrat me përdorim të dyfishtë dhe mallrat ushtarake në përputhje me listat e publikuara nga Bashkimi Europian.
3. Përditësimi i listave të kontrollit për mallrat që mund të përdoren për torturë, trajtim çnjerëzorë, apo dënim me vdekje.
4. Vazhdimi i bashkëpunimit me partnerët për për implementimin e legjislacionit.

B) Lëshimi i dokumenteve ligjore: licenca, autorizime dhe certifikata.

Gjatë vitit 2024 në total janë shqyrtuar 40 aplikime të ndryshme në fushën e mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

1) Në fushën e transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake;

Për vitin 2024 ka patur një interesim më të ulët të subjekteve private dhe shtetërore në lidhje me eksportet e mallrave ushtarake por ka patur një shtim në importet.

Gjatë vitit 2024 janë rinovuar 4 certifikata e rregjistrimit të subjekteve egzistuese dhe janë rregjistruar 2 subjekte të reja. Numri total i subjekteve të rregjistruara është 22.

Për vitin 2024:

- Janë lëshuar 1 Licensë eksporti i përkohshëm për mallra ushtarake
- Janë lëshuar 33 Liçensa importi për mallra ushtarake.

- Janë lëshuar **6** Licensa transiti për mallra ushtarake.
- Janë lëshuar **4** Licensa transshipi për mallra ushtarake.
- Është lëshuar **1** Çertifikata të përdoruesit të fundit për mallra ushtarake,
- Janë lëshuar **2** Certifikatë Rregjistrimi

Tabelat me të dhënat e dokumentave ligjorë të lëshuara në fushën e mallrave ushtarake janë paraqitur në Anekset, bashkëlidhur këtij raporti.

2) Në fushën e transferimeve ndërkombëtare të mallrave me përdorim të dyfishtë;

Edhe për vitin 2024 ka patur një kontroll më efektiv të mallrave me përdorim të dyfishtë.

Një nga çështjet kryesore në vitet e mëparshme ka qenë ai i një kontrolli efikas mbi mallrat dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë, kontroll ky, i cili kërkon bashkëpunimin e ngushtë me autoritetet doganore, të cilat kryejnë kontrollin fizik ndaj këtyre mallrave nëpër pikat doganore. Për të realizuar në mënyrë efikase kontrollin mbi këto mallra, ka qenë i domosdoshëm implementimi i listës së kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë në sistemin doganor të mallrave, aktualisht “ASYCUDA World”.

Për vitin 2024:

- Janë lëshuar **7** Liçensa eksporti për mallra me përdorim të dyfishtë
- Janë lëshuar **153** Liçensë importi për mallrat me përdorim të dyfishtë
- Janë lëshuar **41** Licensa për transferim software
- Është lëshuar **1** Çertifikata të përdoruesit të fundit për mallra me përdorim të dyfishtë

Si rezultat i implementimit të listave të mallrave ushtarake e mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë në sistemin “Assicuda World”, gjatë vitit 2024 ka patur një volum të madh kontrolli të subjekteve tregtare.

- Gjatë vitit 2024 janë shqyrtuar 410 aplikime për dhe janë lëshuar 356 vërtetime përjashtuese.

Si rezultat i këtij kontrolli janë lëshuar licensa individuale importi për mallrat me përdorim të dyfishtë.

Tabelat me të dhënat e dokumentave ligjorë të lëshuara në fushën e mallrave me përdorim të dyfishtë janë paraqitur në Anekset, bashkëlidhur këtij raporti.

3) Në fushën e prodhimit, çaktivizimit, riparimit të armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve të tyre;

Me hyrjen në fuqi të ligjit 74/2014 datë 10.07.2014 “Për Armët”, i ndryshuar, Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, kontrollon dhe liçenson veprimtaritë e Import-Eksport si dhe prodhimin/ çaktivizimin dhe riparimin e armëve të zjarrit dhe pjesëve përbërëse dhe municioneve të tyre.

Baza ligjore për ushtrimin e kësaj veprimtarie:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 658 datë 29.07.2015
“Për përcaktimin e procedurave për dhënien e Licensave për prodhimin, çaktivizimin dhe riparimin e Armëve”

Për vitin 2024:

- Nuk ka patur aplikime për licenca për Prodhimin, Çaktivizimin dhe riparimin e armëve (municioneve)

*Me ndryshimet ligjore të ligjit për Armët 74/2014 datë 10.07.2014 “Për Armët”, i ndryshuar me ligjin nr.75/2023, datë 14.9.2023, veprimtaria e çaktivizimit, prodhimit dhe demilitarizimit nuk është më kompetencë e e AKSHE - së.

Fusha e Lëndëve plasëse dhe Artikujve Piroteknike

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve me ndryshimet në legjislacionin e lëndëve plasëse dhe artikujve piroteknike ka si detyrë funksionale shqyrtimin e aplikimeve për import, eksport, tranzit dhe prodhim të lëndëve plasëse për përdorim civil si dhe të artikujve piroteknike.

Legjislacioni kombëtar që mbulon veprimtarinë e lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike për përdorim civil përbëhet nga:

- I.Ligji nr. 73/2021 *“Për hedhjen në treg dhe mbikqyrjen e artikujve piroteknike për përdorim civil”*
- II.Ligji nr. 74/2021 *“Për hedhjen në treg dhe mbikqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”*.
- III.Vendim i Këshillit të Minsitrave Nr. 509, datë 30.08.2023 *“Për përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit dhe autorizimit, dokumenteve shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë apo autorizim, afatit të vlefshmërisë së licencës dhe autorizimit, procedurave të shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe afateve për kryerjen e tyre, si dhe procedurave të shfuqizimit/pezullimit të licencave e autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin,transitimin e artikujve piroteknikë”*
- IV.Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 247, datë 30.04.2025 *“Për procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, eksportimin, transitimin e lëndëve plasëse për përdorim civil”*
- V.Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 30.07.2004, *“Për procedurën e aplikimit për regjistrimin e lëndëve plasëse në regjistrin shtetëror të lëndëve plasëse për përdorim civil”*, i ndryshuar.
- VI.Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 646, datë 22.11.2023 *“Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe të identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil”*
- VII.Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 15.12.2021 *“Për miratimin e rregullave dhe procedurave të krijimit të sistemit të gjurmimit të artikujve piroteknikë”*

Në fund të vitit 2019 dhe në vazhdim, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 675, datë 28.9.2016 “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe të identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil, filloi puna për lëshimin e Numrave unik Identifikues për lëndët plasëse më përdorim civil, për të bërë të mundur gjurmimin e lëndëve plasëse në çdo kohë.

Janë lëshuar nga AKSHE -ja 10 Numra Identifikues Unik (NIU), 9 (nëntë) prej të cilave për subjektet prodhuese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që importohen nga subjekte shqiptare dhe 1 (një), për subjekt prodhues brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu janë njoftuar pranë AKSHE-së, 19 (nëntëmbëdhjetë), NIU, për subjekte që prodhojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë por ky numër është vendosur nga Autoritetet përgjegjëse të Bashkimit Europian.

Gjatë vitit 2024 janë inspektuar në mënyrë periodike subjektet për zbatimin e detyrimeve për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të gjurmimit të lëndëve plasëse për përdorim civil duke lënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e sistemit.

Gjithashtu janë kryer inspektime të rregullta për ështjet e sigurisë dhe mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpëtimit, kryesisht gjatë periudhës së nxehtë me specialistët e vendosur në dispozicion nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së

C) Lëshimi i Liçensave në fushën e lëndëve plasëse për përdorim civil si dhe lëndëve piroteknike, fishekzjarre

Për vitin 2024 janë lëshuar:

- Janë lëshuar 6 Liçensa Importi të lëndëve plasëse për përdorim civil,
- Janë lëshuar 7 Liçensë Eksporti të lëndëve plasëse për përdorim civil
- Është lëshuar 1 Liçensë Importi të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarre për përdorim civil
- Janë lëshuar 3 Autorizim importi për artikuj piroteknike
- Janë lëshuar 6 Autorizim eksporti për artikuj piroteknike
- Është lëshuar 1 Liçensë Prodhimi për nevoja testimi të lëndëve plasëse.

Fusha e ndalimit të mallrave të cilat mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve me miratimin e paketës ligjore tashmë është përgjegjës për kontrollin dhe licensimin e produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

Legjislacioni në këtë fushë;

- Ligji 27/2023, *“Për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”*
- Vendimi Nr. 806, datë 28.12.2023 *“Për miratimin e listave të mallrave, që mund të përdoren ose nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të cilat janë objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”* Ky vendim është përafruar pjesërisht me rregulloren (BE) 2019/125 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 janar 2019, *“Për tregtinë e mallrave të caktuara, të cilat mund të përdoren për dënim me vdekje, torturë apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese”*.
- Vendimi Nr. 323 11.06.2025, *“Për miratimin e modeleve standarde të autorizimeve, individuale, të përgjithshme e globale, për tregtimin e produkteve, që janë objekt i kontrollit shtetëror, të cilat mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, e të formateve të kërkesave për këto dokumente dhe përcaktimin e afateve, procedurave e tarifave për lëshimin e autorizimeve”*.

Ç) Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë, kombëtarë, bashkëpunimi me Autoritetet homologe, dhe pjesëmarrja në konferenca dhe seminarë, në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve;

Edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bashkëpunimi i frytshëm me organizmat ndërkombëtarë të cilët asistojnë AKSHE-në.

I. EXBS (*Export Control And Border Security*), pranë Departamentit të Shtetit Amerikan ka mundësuar pjesmarrjen aktive gjatë kësaj periudhe të punonjësve nëpër seminare dhe konferenca të ndryshme si dhe ka ofruar asistencën për ndryshimet ligjore dhe ngritjen e kapaciteteve.

II. SEESAC (*South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse for the Control of the Small Arms and Light Weapons*), në zbatim të projektit rajonal mbi kontrollin e eksporteve ka realizuar seminare dhe konferenca të ndryshme me vendet e rajonit. AKSHE-ja është pjesë e Roadmap për kontrollin e armëve të vogla e të lehta

III. COARM, (*EU Council Working Party on Conventional Arms Exports*) gjatë kësaj periudhe kemi bashkëpunuar me iniciativën e ndërmarë nga COARM, për shkëmbimin e informacionit me vendet e tjera anëtare të BE-së, me qëllim identifikimin e Përdoruesëve të fundit dhe ngritjen e një sistemi të klasifikuar të shkëmbimit të të dhënave me vendet e Bashkimit Europian.

IV. *France Expertise*, e mandatuar nga Komisioni Europian për implementimin e Programit EU P2P për Kontrollin e mallrave me përdorim të dyfishtë ka mundësuar pjesmarrjen aktive gjatë kësaj periudhe të punonjësve nëpër seminare dhe konferenca të ndryshme si dhe ka ofruar asistencën për ndryshimet ligjore dhe ngritjen e kapaciteteve.

Regjimet e kontrollit të mospërhapjes së armëve të Shkatërrimit në Masë

Edhe pse Legjislacioni Shqiptar mbi kontrollin e eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë dhe lista kombëtare e kontrollit të mallrave ushtarake janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, Shqipëria nuk është ende pjesëmarrëse në disa marrëveshje ndërkombëtare në këtë fushë.

Qëllimet kryesore të këtyre regjimeve janë identifikimi i mallrave dhe teknologjive subjekte të kontrollit të eksporteve, shkëmbimi i informacionit mbi rrezikun e përhapjes si dhe promovimi i mospërhapjes të armëve të shkatërrimit në masë në vendet jo-anëtare të tyre.

1. Marrëveshja e Wassenaar-it
2. Grupi i Australisë
3. Grupi Furnizues Nuklear
4. Komiteti i Zangger-it
5. Regjimi i Kontrollit të Teknologjisë së Armatimit

Me iniciativë të AKSHE-së, së bashku me ministrinë e Mbrojtjes, janë analizuar kriteret për anëtarësim dhe i janë përcjellë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme e cila ka shprehur dakortësinë për fillimin e procedurave të anëtarësimit. Gjatë vitit 2024 janë marrë kontakte me Sekretariatit e Wassenarit i cili përcolli procedurat e anëtarësimit dhe kriteret specifike për përgatitjen e dosjes. AKSHE-ja, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, e përgatiti dosjen e aplikimit dhe e ka paraqitur pranë Sekretariatit të Wassenar, por aplikimi është bllokuar nga Rusia.

D) Bashkëpunimi me Insitucionet kombëtare në fushën e kontrollit të eksporteve

Gjatë vitit 2024 një fokus i lartë i është dhënë bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe me autoritetet homologe në vende të huaja.

AKSHE-ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me Shërbimin Informativ Shtetëror për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi, me Drejtorinë e Përgjithshme të Pastrimit të Parave, me ALBCONTROLLIN.

- Bashkëpunimi me doganat;

Me drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ka vazhduar në mënyrë të pandërprerë bashkëpunimi. Në mënyrë të vazhdueshme kemi patur shkëmbim informacioni, inspektime të përbashkëta si dhe jemi takuar rregullisht për problematika në fushën e kontrollit të mallrave strategjike.

- Takimet me Grupin teknik të Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

AKSHE-ja si përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes merr pjesë në grupin Teknik Ndër-institucional të kryesuar nga AIF.

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve merr pjesë rregullisht në takimet mbi;

- Strategjinë për kontrollin e armëve të vogla, të lehta, (AVL) municioneve dhe eksplozivëve 2019 –2024 dhe plani i veprimit 2021 -2024.

Gjatë vitit 2024, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve ka marrë pjesë në mënyrë aktive për hartimin e Strategjisë së AVL-ve si dhe është pjesë e Komisionit Kombëtar për AVL-të.

- Strategjinë Kombëtare për mos përhapjen e armëve të dëmtimit në masë, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, ka marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e Draft Strategjisë Kombëtare për mos përhapjen e armëve të dëmtimit në masë.

DH) Bashkëpunimi me Autoritetet homologe

Në kuadër të bashkëpunimit me Autoritet Homologe, gjatë vitit 2024 kemi shkëmbyer informacion të rregullt me autoritetetet përgjegjëse për kontrollin e transferimit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë në Republikën e Kosovës. Kemi organizuar një seminar informues mbi legjislacionin dhe procedurat e AKSHE-së. Kemi lidhur urat e komunikimit për bashkëpunim në të ardhmen.

Për të formalizuar bashkëpunimin në 25 Maj të vitit 2016, AKSHE-ja, ka lidhur një Marrëveshje Bashkëpunimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në Republikën e Kosovës, për "Bashkëpunimin në Kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë"

Po ashtu me autoritet homologe të rajonit kemi patur shkëmbime informacioni (jo konfidenciale) të ndryshme për transferime të cilat preknin vendin tonë ose ndonjë vend në rajon.

Gjithashtu janë marrë kontakte bashkëpunuese me organizma dhe autoritete ndërkombëtare të tjerë, bashkëpunim i cili pritet të thellohet në të ardhmen.

E) Përgatitja e Raportimeve Vjetore në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare.

Në zbatimin të rezolutave dhe programeve të OKB-së dhe OSBE-së, mbi armët konvencionale dhe armët e vogla e të lehta, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror raporton në mënyrë vjetore mbi transferimet ndërkombëtare të këtyre kategorive. Kjo kontribuon përveçse në plotësimin e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë si vend anëtar i këtyre organizatave edhe në transparencën transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarakë.

Gjatë vitit 2024 AKSHE-ja ka raportuar në këto organizata:

Për Organizatën e Kombeve të Bashkuara OKB:

- Përgatitja e raportit vjetor kombëtar mbi transferimin (eksport - import) e Armëve Konvencionale.
- Përgatitja e raportit vjetor kombëtar mbi transferimin (eksport - import) e Armëve të Vogla e të Lehta.
- Përgatitja e Pyetësorit vjetor “Questionnaire on participating states’ policy and/or national practices and procedures for the export of conventional arms and related technology”
- Përgatitja e Pyetësorit vjetor “Reporting Template for the implementation of the. Programme of Action to Prevent, Combat and Eradicate the Illicit Trade in. Small Arms and light Weapons”

Për Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE)

- Përgatitja e raportit vjetor kombëtar mbi transferimin (eksport - import) e Armëve Konvencionale.
- Përgatitja e raportit vjetor kombëtar mbi transferimin (eksport - import) e Armëve të Vogla e të Lehta.

Për Konventën e Armëve Kimike;

- Përgatitja e raportit vjetor për Organizatën e Ndalimit të Armëve Kimike (OPCW)

Për Konventën e Armëve Biologjike;

- Përgatitja e raportit vjetor për Konventën e Armëve Biologjike

Në kuadër të bashkëpunimit Rajonal nën ndihmën e SEESAC dhe EXBS;

- Kemi përgatitur dhe publikuar **Raportin e Përbashkët Rajonal** për vendet e Ballkanit Perëndimor për Eksportin e mallrave Ushtarake për vitin 2023.
- Këto Raporte publikohen në faqen www.seesac.org.

Plani Kombëtar i Integritetit European

Në kuadër PKIE-së, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror merr pjesë si kontribues në tre Kapituj :

➤ Kapitulli 1, Lëvizja e lirë e Mallrave

Në këtë kapitull AKSHE-ja është përgjegjëse për Lëndët Plasëse për Përdorim Civil si dhe Lëndët piroteknike dhe fishekzjarrë për përdorim civil.

➤ Kapitulli 30, Marrëdhëniet me Jashtë

Në këtë kapitull AKSHE-ja është përgjegjëse për Mallrat me përdorim të Dyfishtë

➤ Kapitulli 31, Politikat e Jashtme, të Mbrojtjes dhe të Sigurisë

Në këtë kapitull AKSHE-ja është përgjegjëse për Mallrat Ushtarake.

Gjatë vitit 2024 në lidhje me këto tre kapituj AKSHE-ja ka raportuar rregullisht mbi të gjitha zhvillimet në këto fusha, si dhe ka marrë pjesë në të gjitha trajnimet e organizuara nga Institucionet lider. Gjithashtu AKSHE-ja në këto kapituj ka caktuar personat përgjegjës dhe pikat e kontaktit të cilët marrin pjesë në grupet ndërinstitutional të punës.

Nga ana tjetër përfaqësuesit e AKSHE-së, kanë marrë pjesë në takimet e bilateralit me Komisionin European për kapitujt ku kontribuon duke përgatitur prezantimet përkatëse.

Ë) Vijimi i trajnimit të personelit.

Gjatë vitit 2024 është bërë e mundur pjesëmarrja në konferenca dhe seminarë të ndryshëm për qëllime si trajnuese ashtu edhe bashkëpunuese me organizmat ndërkombëtar të fushës.

Raporti me industrinë

Duke qënë se industria është një nga aktorët kryesor në kontrollin e eksporteve, bashkëpunimi lind si një nevojë e domosdoshme.

Me operatorët ekonomikë të cilët kryejnë aktivitet tregtar në fushën e eksporteve janë zhvilluar takime në të cilat janë diskutuar problematika të ndryshme.

Në kuadër të reformës së ri-inxhinierimit dhe derregullimit AKSHE-ja, me financim të Departamentit të Shtetit, nëpërmjet programit EXBS, ka zhvilluar një sistem për aplikimin online të licensave.

Për të lehtësuar dhe për të patur një informacion sa më të disponueshëm AKSHE, ka edhe një faqe zyrtare interneti: www.akshe.gov.al ku subjektet mund të gjejnë formularët e aplikimeve, informacionet mbi procedurat që duhet të ndjekin, legjislacionin, listën e mallrave si dhe ku mund të shkruajnë e të marrin përgjigje mbi çdo gjë të nevojshme. Kësaj i shtohen kontaktet telefonike dhe adresa elektronike info@akshe.gov.al, ku subjektet mund të kërkojnë informacione apo sqarime të mëtejshme.

Objektivat e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

Objektivat aktuale të AKSHE-së janë:

- Forcimi më tej i bashkëpunimit me institucionet shtetërore të cilat janë pjesë e sistemit të kontrollit

shtetëror shqiptar të eksporteve sidomos me:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave,
 - Agjensitë e Inteligjencës së Republikës së Shqipërisë (SHISH, AISM, etj.) për shkëmbimin e informacioneve në lidhje me subjektet e përfshira në veprimtari të paligjshme;
 - Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Dhomën Kombëtare të Tregtisë për sa i përket bashkëpunimit me subjektet tregtare;
 - Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
 - Autoriteti i Aviacionit Civil,
- Përditësimi dhe miratimi i listës së re të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë
- Implementimi i legjislacionit për produktet që kanë për qëllim torturën, trajtimin ç'njerëzor dhe dënimin me vdekje.
- Forcimi i kontrollit Fizik pranë pikave të kalimit doganor
- Ndërgjegjësimi i subjekteve tregtare për domosdoshmërinë e pajisjes me liçensë/autorizim import-eksporti për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë;
- Organizimi i konferencave dhe seminarëve të përbashkët me përfaqësues të institucioneve të lart përmendura e me subjektet tregtare për të nxitur frymën e bashkëpunimit si dhe për të ofruar gjithë informacionet e nevojshme.
- Përpilimi i drafteve për ndryshimet ligjore, për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së
- Vazhdimin e procedurave të anëtarësimit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në regjimet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të kontrollit të eksporteve.
- Vazhdimësia e punës duke shtuar shkallën e profesionalizmit me qëllim ushtrimin efikas të kompetencave ligjore.
- Krijimi i sistemit të Kontrollit të Përpunueshmërisë së Brendshme për Subjektet Tregtare.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është përmirësimi dhe harmonizimi me normativat e BE-së, i legjislacionit specifik për kontrollin e eksporteve si dhe për lëndët plasëse për përdorim civil dhe fishekzjarreve.